

## **SEKTORI INFORMAL EKONOMIK, NJË KËRCNIM SERIOZ PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE ASPIRATAT INTEGRUESE TË VENDEVE NË TRANZICION**

Tema e ekonomisë jolegale dhe fenomenet shoqëruese të saja të personifikuara në korupcion, ryshfet, evazion fiskal, monopole informale dhe distorzione të konkurrencës janë karakteristika dalluese që shoqërojnë procesin e tranzicionit në kontinuitet.

Debati profesional dhe publik, përpilimi i strategjive për luftimin e ekonomisë informale dhe evazionit fiskal dhe detyrimet si rekomandime nga institucionet financiare dhe politike ndërkombëtare vazhdojnë të jenë obligime permanente në kuadër të proceseve të bashkëpunimit ekonomik dhe integritimeve euroatlantike.

Është për tu veçuar paradoksi që konsiston në faktin se përkundër intensifikimit të debatit për fenomenin në fjalë i njëjti në shumicën e vendeve në tranzicion ku reformat ekonomike janë të vonuara dhe të dështuara fiton në intenzitet edhe më të madhë.

Gjatë dekadës që e lam pas shumë ish vende socialiste që kishin ekonominë e bazuar në planifikimin qendror e nisën procesin e tranzicionit duke synuar transformimin e ekonomive të tyre në ekonomi funksionale të bazuara në ligjëshmëritë e tregut dhe në pronën private.

Suksesshmëria e procesit në fjalë krahas zbatimit të reformave të një spektri mjaftë të gjërë legjislativ, pronësor, strukturor, monetar dhe fiskal nënkuptonte edhe krijimin e institucioneve të nevojshme funksionale publike dhe një rol komplementar të qeverive në raport me ekonominë e tregut.

Praktikat e deritashme të procesit të tranzicionit në ekonominë jo të suksesshme tranzitore kanë nxjerrë në sipërfaqe mosfunksionimin e shtetit në ekonomi si një nga mangësit kryesore të periudhës së deritashme tranzitore dhe sfidën kryesore që do të shoqëron këtë proces të ndërlikuar të transformimit ekonomik dhe politikë në të ardhmen.

- **Si funksionuan institucionet shtetërore në periudhën e deritashme tranzitore ?**

Për të ushtruar detyrimet e veta publike qeverit kanë nevojë për institucione mirë të zhvilluara dhe të udhëhequra nga personalitete kompetente të stimuluar

financiarisht në mënyrë transparente dhe të ndershme. Krjimi i institucioneve funksionale dhe të depolitizuara shtetërore dhe publike kërkon periudha shumë më të gjatë kohore të vendet ekonomikisht të varfëra dhe në të cilat kultura demokratike dhe depolitizimi i administratës publike janë në nivele mjaftë të ulta.

Resurset e pamjaftueshme materiale dhe humane në dipozicionin, koha e shkurtër në dispozicion dhe mbi të gjitha keqpërdorimet e pushtetit nga elitat politike në vazhdimësi ishin ndër shkaqet kryesore të dështimit të krijimit të institucioneve funksionale dhe të depolitizuara në vendet në tranzicion në përgjithësi dhe në atë kuadër edhe në vendet e EJJ.

Në një analizë të tij **Andrei Schleifer (1996)** do të konstatoj:

„Liberalizimi i çmimeve do të eliminon kontrollin e qeverisë mbi çmimet, stabilizimi do të imponon një politikë të shtërnguar buxhetore qeveritare dhe privatizimi do të eliminon kontrollin e drejtpërdrejtë qeveritar mbi ndërmarjet.

Këto ndryshime janë të mjaftueshme për të shkatruar ekonomin e bazuar në planifikimin qendror por nuk janë të mjaftueshme për të transformuar këto ekonomi në ekonomi funksionale të tregut dhe për të ndërtuar institucione shtetërore kompatible me nevojat e ekonomisë së tregut,„

- **Ekonomia informale dhe evazioni fiskal pasojë e tranzicionit ekonomik të pasuksesshëm**

Në qarqet teorike shkencore dhe në institucionet kryesore financiare ndërkombëtare është arritur pajtueshmëri e plotë për një qasje gjithëpërfshirëse me qëllim të menaxhimit simultan të çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me tranzicionin ekonomik.

Si çështje kryesore të tranzicionit ekonomik u identifikuan :

- 1) Liberalizimi ekonomik,
- 2) Stabilizimi ekonomik dhe
- 3) Reformat strukturore të ekonomive në tranzicion.

Çështja e liberalizimit ekonomik ka të bëjë kryesisht me liberalizimin e çmimeve dhe liberalizimin e regjimit të tregëtis.

Çështja e stabilizimit ekonomik ka të bëjë me stabilitetin monetar, stabilitetin e kursit të këmbimit të valutës vendore, stabilitetin fiskal, stabilitetin e bilancit të pagesave dhe arrijtjen e normave stabile të rritës ekonomike.

Çështja e reformave strukturore përfshin një vistër më të gjërë të sektorëve ekonomik dhe kryesisht i dedikohet procesit të privatizimit, reformimit të sektorit

financiar, reformimit të administratës publike, institucionalizimit të tregjeve financiare, reformimit të sistemit gjyqësor dhe krijimit të ambientit stabil dhe atraktiv investues.

Procesi i tranzicionit ekonomik në fazën fillestar të projektimit dhe implementimit praktikë efektuoi në tepër ndryshime radikale në ekonomi dhe në institucionet shtetërore.

Për elaborimin e temës së ekonomisë informale vlen të theksohen ndryshimet vijuese:

- Eliminimi i Planit ekonomik eliminoi informacionet ekonomike për vëllimin e prodhimit dhe çmimet me të cilat prodhimet ishin realizuar. Në situatën e re ekonomike qeverit duhej të supstitionin humbjen e këtij burimi të rëndësishëm të informatave ekonomike me burime të tjera alternative që duhej të vinin nga deklaratimet e kompanive dhe tatimpaguesve privat.

Informata nga burimet e reja ishin kryesisht joprecize dhe të vonuara që për pasojë efektuan evazion të gjërë fiskal.

- Në mënyrë dramatike u rit numri i kompanive private prodhuese dhe tregëtare në cilësinë e tatimpaguesve potencial. Administrata tatimore e cila në të kaluarën kontrollonte një numër të kufizuar të tatimpaguesve, në situatën e re me numrin e vogël të të punësuarëve, financiarisht e pamotivuar, pa paisje të nevojshme teknologjike, kryesisht ishte e papregaditur për të menaxhuar me efektivitetet dhe efikasitet kontrollin fiskal mbi një numër tejet të madhë të tatimpaguesve kryesisht të pavullnshëm për të paguar tatimet.

Për pasojë evazioni fiskal u rritë dukshëm duke përfshirë edhe koruptimin masiv të administratës tatimore.

- Ndërmarjet e mëdha shtetërore të cilat siguronin pjesën më të madhe të të ardhurave fiskale kryesisht humbën rëndësinë që e kishin në sistemin paraprakë, ndërsa sektori privat i ekonomisë i cili në mënyrë dinamike bëhej sektori dominant i ekonomisë u segmentua dhe diversifikua shumë në aspekt të tatimpagimit.

Për pasojë administrata tatimore ishte e privuar ose e pamundësuar në aspekt dinamik të realizon kontrollat fiskale dhe të lufton evazionin fiskal sepse kompanit që funksiononin në ekonomin informale manipulonin me më shumë subjekte juridike dhe pasi që realizonin evazionin fiskalë falimentonin kompanit duke bartur pronën dhe biznesin në kompani tjetër.

- Ofrimi i alternativës së pagesave në mes të subjekteve ekonomike dhe të pagesës së tatimeve dhe taksave nëpërmjet më tepërë xhirrollogarive nëpërmjet

bankave të ndryshme vështirësuan kontrollin dhe grumbullimin e të hyrave fiskale dhe rritën evazionin fiskal.

- Legjislacioni fiskal, tregëtar dhe ai i bankrotit të kompanive së bashku me mosfunksionimin azhur të gjykava edhe organeve që institucionalisht duhej të luftonin ekonomin informale dhe evazionin fiskal krijuan hapsirën e nevojshme juridike dhe institucionale për praqitjen dhe zhvillimin e këtij fenomeni.

Ndryshimet e përmedura më lart dhe të tjerat të papërmendura nxjerin në sipërfaqe faktin se përse sistemi i vjetër tatimor dhe ai juridik në përgjithësi nuk mundej të reformohej shpejt dhe të jetë efikas në përmbushjen e nevojave publike në rritje. Sistemi i ri tatimor nuk kërkonte vetëm legjislacionin e ri por edhe institucionet e reja fiskale, menaxhement kuadrovik me dije të reja, financiarisht të motivuar dhe dhe të depolitizuar, kushte këto që kryesisht nuk u plotësuan.

Ligjet e reja tatimore në vendet në tranzicion kryesisht u kopjuan nga vendet perëndimore, mirëpo institucionet e reja fiskale duhej të krijoheshin në koekzistencë me administratën e vjetër socialiste dhe në kushte kur integriteti i institucioneve shtetërore rënohej me dinamik mjaftë të shpejtë.

Ndikimi i përfaqësuesve të pushtetit politik legjislativ, ekzekutiv dhe lokal mbi administratën tatimore me qëllim të zvoglimit të detyrimeve tatimore të tatimpaguesve të cilët financonin aktivitetet e tyre politike u rrit dukshëm.

Në shumicën e vendeve në tranzicion janë bërë përpjekje të arnohen institucionet e vjetra tatimore dhe të bëhen ato se gjoja funksionojn sikur me qen të reja. Mirëpo reformimit të arnuar të administratës shtetërore i përshtatet përmbajtja e një proverbi popullor "se është shumë vështirë tu mësosh qenëve të vjetër truqe të reja".

Shumica e qeverive dështuan në kuptimin ose pranimin e të vërtetës se në ekonomin e tregut sistemi tatimor duhet të ketë kryesisht të vetmin objektiv bazë atë të rritjes së të hyrave fiskale në një mënyrë efikase dhe të drejtë dhe përballimit të shpenzimeve buxhetore klasike.

Përkundrazi, sistemit tatimor në vendet në tranzicion iu ngarkuan shumë më tepër objektiva si psh. duhej të financonte kostot sociale të kompanive të falimentuara duke u paguar kompanive që krijojnë humbje pagat e të punësuarëve në vend se këto kompani të paguanin tatimet. Një rast më eklakant i kësaj natyre në Maqedoni është fenomeni i kompanive të ashtuquajtura "Humbësit e mëdhenjë" që u alimentuan nga

mjetet buxhetore më shumë se 10 vite dhe që i kushtuan buxhettit të shtetit qindra milion dollarë.

Në një ambient të kësaj natyre ku institucionet fiskale të shteteve në tranzicion humbën garrën me sektorin privat në aspekt të kontrollit të aktivitetit afarist të kompanive private dhe në aspekt të arkëtimit të ardhurave fiskale për pasojë u krijua një sektori i fuqishëm i ekonomis informale i shoqëruar me evazion të gjërë fiskal.

- **Definimi i sektorit informal**

Sektori informal në pajtim me literaturën e gjërë dhe në veçanti sipas definicioneve të autorëve Schrage (1984) dhe Thomas (1992) përkufizohet: "Një bashkësi aktivitetesh që në parim ushtrohen legalisht dhe që duhet ti nënshtrohet tatimit por që nuk deklarohen si aktivitete komerciale legale dhe të cilat nuk përfshihen në vlerën e të ardhurës kombëtare ose që pjesërisht përfshihen në PBB"

Pjesëmarja në sektorin informal paraqet thyerje të normave legale pavarësisht që aktivitetet në fjalë në një farë mënyre ushtrohen në mënyrë legale.

Bartësit e aktiviteteve të sektorin informal ekonomik koruptojn autoritetet publike ashtu që zyrtarët "dobët të paguar" pranojnë ryshfete si këmbim për mbrojtjen ose për favorizime që i bëhen sektorit jolegal ekonomik duke dëmtuar financat publike dhe duke deformuar konkurrencën në treg.

Në këto suaza vlen të përmenden në veçanti keqpërdorimet e shumta që bëheshin dhe që vazhdojnë të bëhen në procesin e privatizimit të kompanive shoqërore dhe publike, dhënjen e kontigjenteve, dhënien e koncesioneve dhe preferencave importuese firmave të afërta me qeveritarët, përcaktimin e firmave fituese në tenderët për kryrejen e punëve publike, deklarimin e nënvlerësuar të mallërave të importuara gjatë doganimit dhe tatimit, shitjet me diskonte maksimale prej mbi 90% të vlerës kontabël të kompanive shtetërore në bazë të kontraktiveve direkte dhe raste të tjera.


Literatura e viteve të fundit dhe në atë kuadër edhe FMN/ja ka pranuar definicionin sipas të cilit në sistemet e zhytura në ryshfet dhe korrupcion iniciativat ekonomike janë të shtrembëruara pasi që "zyrtarët qeveritar dhe individ privat të favorizuar pranojnë pjesë të mëdha të dobive publike ose financojnë pjesë më të vogla të shpenzimeve nga të cilat ofrohen të mirat publike.

Si pasojë kemi më pak të ardhura qeveritare, investime më të ulta private dhe rritje të varfërisë dhe jobarazisë së qytatarëve. Studime të shumta të kohës më të re konfirmojn ekzistimin e një korelacioni negativ ndërmjet korrupsionit dhe rritës

ekonomike duke potencuar rëndësinë kryesore të përmirësimit të qeverisjes si element kyç i programit të suksesshëm reformues ekonomik.

Grafikoni i mëposhtëm pasqyron funksionimin paralel të ekonomisë informale dhe ekonomisë formale. Ky funksionim paralel i ekonomive realizohet në kuadër të një ambienti të përbashkët në të cilin koekzistojnë tre faktorë qeveria, konsumatorët (votuesit) dhe kompanit.

**Grafikon :Ekonomia duale e stilizuar**



**Burimi:FMN,(Alesina ,1999)**


Grafikoni i mësipërm pasqyron lidhjet funksionale dhe koekzistimin e sektorit formal dhe joformal në kuadër të ambientit të përgjithshëm ekonomik, në të cilën koekzistencë paguesit e tatimeve paguajnë provizion për të mirat publike tek të cilat ndërmarjet që "lirshëm kalojnë" kanë qasje të kufizuara.

Risqet kryesore të cilat kërcënojnë realizimin e dy objektivave qeveritare afatgjate, atë të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe integrimin në Bashkësinë Europiane rrjedhin nga strukturat që mbrojnë pozicionet dhe interesat ekonomike që kryesisht kanë krijuar pasuri të mëdha nga aktivitetet komerciale në sektorin jolegal ekonomik dhe që në tregjet e ekonomive në tranzicion kanë krijuar pozicione monopoli.

Është mjaftë sinjifikativ fakti që përkundër ngecjes rapide në zhvillimin ekonomik, varfëris së lartë dhe githëpërfshirëse dhe papunësis tepër të lart në një të anë gjithandej vendeve në tranzicion nuk mungojn **"kapitalistët e shumtë tranzitor"** të cilët kanë krijuar pasuri të mëdha ekonomike kryesisht në kuadër të aktivitetit ekonomik jolegal. Shumica e kapitalistëve tranzitor nuk janë në gjendje të dokumentojn prejardhjen e kapitalit nëpërmjet raportve legale financiare dhe fiskale të bizneseve të cilat i ushtrojnë legalisht në ekonomin kombëtare ose në tregjet ndërkombëtare.

Ndërmarrjet që funksionojn në kuadër të ekonomis jolegale kanë mundësi të ofrojnë mallrat dhe shërbimet me çmime relativisht më të ulta pasi që nuk paguajn ose pjesërisht paguajn tatime në konsum dhe në fitim dhe kontributet në fondet për sigurimet sociale.

**Grafikon: Rrethi Vicioz i sektorit jolegal**



Grafikoni i mësipërm pasqyron lidhjen kauzale në mes të sektorit të zhvilluar informal ekonomik në një anë dhe "qeverive demokratike" në vendet në tranzicion që ekuilibrohet me humbje të konsiderueshme të të ardhurave buxhetore dhe ofertën e dobët të shërbimeve publike.

Në analizat e më shumë autorëve të mbrendshëm dhe të jashtëm është argumentuar se politikat e gabuara në ekonomi efektuojn **"rethin vicioz"** që e konstaton **Alesina (1999)** dhe këto politika qeveritare të konvergjojnë në një gjendje

ekuilibruese të ekonomis me një sektor të gjërë jolegal, grumbullim të dobët të tatimeve, të hyra tatimore të ulta dhe shërbime publike të varfëra duke përfunduar motivin e kompanive ekonomike të vazhdojnë të funksionojnë edhe më tej në mënyrë informale.

Në ekonominë në të cilat ekziston sektori i gjërë jolegal ekonomik përfundohen iniciativat për të ngjellur në gjendjen e një ekuilibri suboptimal me qeveri të parëndësishme qendrore dhe lokale funksionalisht joefektive në aspekt të ofrimit dhe përmbushjes së kërkesave publike të qytetarëve dhe kryerjes së funksioneve qeveritare.

Pjesëmarës individual në kuadër të ekonomis jolegale pavarësisht nga statusi i tyre si punëtor, konsumator, votues ose tatimpagues përfitojnë nga statuskujat pasiqë kjo situatë rrit beneficijet e tyre në dëm të interesit shtetëror.

Në mënyrë analoge kompanitë që janë të kyçura në këto aktivitete informale përfitojnë nga kostoja e ulët e pagesës së tatimeve në konsum dhe nga shpenzimet e ulta të pagave dhe në këtë mënyrë ato përmirësojnë aftësitë konkurruese të tyre dhe pozicionin e tyre në treg në raport me konkurrentët e tyre.

Si rezultat i të mësipërmeve politikanët e zgjedhur nuk dëshirojnë të propozojnë dhe zbatojnë reforma që kufizojnë privilegjet dhe përparësitë ekonomike të votuesve të tyre dhe të kompanive të cilat kanë sponsoruar dhe përkrahur financiarisht kampanjat e tyre elektorale.

Duke pasur parasysh faktin se në vendet e analizuara ekzistojnë të dhëna dhe evidencat të pamjaftueshme në lidhje me sektorin zyrtar të ekonomis edhe të dhënat për sektorin informal kryesisht janë të supozuara. Vlerësimi aktual i PBB/së në Shqipëri përfshin në vetë edhe aktivitetin ekonomik informal në nivelin e 30% të prodhimit të përgjithshëm kombëtar, fakt ky unik që dëshmon pajtimin e autoriteteve qeveritare me gjendjen duale të ekonomis.

Kundërshtimi i vendosur dhe mundësisht ndërprerja e mëtejme e rritës së sektorit jolegal ekonomik paraqet sfidën kryesore politike, ashtu që zhvillimi ekonomik dhe ngritja e mirëqenjes sociale duhet detyrimisht të shoqërohet me zvogëlimin e sektorit jolegal ekonomik dhe të arihet në ngarkesë të "benificijëve private" të atyre të cilat shfrytëzojnë dobitë në kuadër të sektorit jolegal ekonomik.

- **Cili është relacioni i pagesave paralele dhe sektorit jolegal ekonomik?**

Analizat e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare kan argumentuara se fenomeni i ekonomisë informale kryesisht financohet nëpërmjet pagesës me para në dorë dhe jashtë kanaleve të sistemit financiar dhe bankar.


Në veçanti gjendja e dobët e të ardhurave fiskale në shtetet në tranzicion shoqërohet me fenomenin mjaftë të zhvilluar të "**pagesave paralele**" nëpërmjet kanaleve legale xhirale dhe kanaleve informale ose në **Cash** që ekziston në kuadër të sektorit të ekonomisë të vendet e analizuara në tranzicion .

**Tabela: Rezervat mesatare të parave të gatshme**

Përshkrimi	Shqipëria	Maqedonia	Bullgaria	Sllovenia
Rezervat mesatare-CASH	Për banor në \$	Për banor në \$	Për banor në \$	Për banor \$
Në vitin 1999	192,3	122,5	68,5	319,3
Në vitin 2001	276,8	178,5	102,2	284,6
Për banor PBB	Dollar \$ Shqipëria=100			
Në vitin 1999	100,0	119,0	144,7	778,4
Në vitin 2001	100,0	125,1	123,6	666,3

**Burimi: IFS, dhe FMN,**

**Grafikon :Rezervat mesatare të parave të gatshme dhe niveli i PBB**



**Burimi: IFS dhe FMN,**

Aktivitetet informale ekonomike kryesisht realizohen nëpërmjet pagesës me para të gatshme (cash) dhe përqindja e parave të gatshme (mjetet devizore dhe pjesërit valuta lokale) në qarkullim në raport me PBB/në e përgjithshme paraqet një sinjal të fuqishëm për prezencën e sektorit mjaftë të fuqishëm informal ekonomik.

Krahasuar me nivelin e të ardhurave për banorë që kanë vendet e analizuara dhe qarkullimit të parave të gatshme në valutë të vendit dhe të huaj në krahasim me vendet fqinje dhe ato tranzitore të EJT, niveli i parave të gatshme është më i lartë në kuadër të vendeve të EJT. Në Shqipëri niveli i parave të gatshme për banor në vitin 2001 është 273,8\$ që ekuilibrohet me 97% e parave të gatshme për banor në Slloveni përkundrahe faktit që niveli i PBB-së për banor është për 666% më i ulët në raport me Sllovenin.

Në Maqedoni niveli i parave të gatshme për banor prej 178,5\$ për vitin 2001 ekuilibrohet me 62,7% e këtij indikator në rastin e Sllovenis përkundrahe faktit që niveli i PBB-së për banor në Slloveni është më i lartë për 532,8% në raport me Maqedonin.

Niveli kaq i lartë i parave të gatshme përkundrahe nivelit shumë të ulët të PBB-së për banor që në parim qarkullon jashtë institucioneve legale financiare dhe bankare i dedikohet kryesisht përkrahjes dhe funksionimit të sektorit informal ekonomik dhe në pikëpyetje të madhe saktësinë e të dhënave statistikore për treguesit kryesor makroekonomik të vendet në tranzicion.

- **Cili është niveli i Ryshfetit tatimor?**

Shqipëria prin në aspekt të pagesës së ryshfetit tatimor jo vetëm në kuadër të vendeve të ranguar në tabelë por edhe më gjërë në radhën e vendeve tranzitore europiane.

**Tabela: Frekuenca dhe niveli i "Ryshfetit Tatimor"**

Përshkrimi	Përqindja e firmave që zbatojn shpesh ryshfetin tatimor		Tatimi mesatar i ryshfetit si % e të hyrave vjetore të firmës	
	1999	2002	1999	2002
Vendet				
Shqipëria	<b>46,7</b>	<b>36,4</b>	<b>1,7</b>	<b>3,3</b>
Bosna e Hercegovina	20,5	22,4	2,1	0,9
Bullgaria	23,0	32,8	1,3	1,9
Maqedonia	<b>33,0</b>	<b>22,7</b>	<b>1,4</b>	<b>0,8</b>
Sllovenia	7,7	7,1	1,0	0,8

**Burimi: IFS dhe FMN,**

Një gjendje e këtyllë tepër negative në lidhje me pagesën tepër të lart të rryshfetit taimor të sektorit të ekonomisë është pasojë e praktikave korruptive që tashmë janë bërë "traditë menaxheriale" e administratës publike në të gjitha nivelet politike si parakusht për të zhvilluar aktivitetin ekonomik formal dhe informal.

Gjendja pak më tolerante dhe me tendenca të përmirësimit është evidentuar në Maqedoni kryesisht si pasojë e rramjes ekonomike në përgjithësi dhe dobësimit të dukshëm të sektorit të ekonomisë.

- **Cili është niveli i korupcionit të vrrojtuar?**

Niveli i Indeksit të korupcionit si trend ka njohur rritje permanente të vendet në tranzicionit të cilat proceset e reformave ekonomike dhe proceset integruuese kanë ngecur përkundra vëndeve në tranzicion të cilat tashmë janë integruar ose janë në fazën e fundit të integritit në strukturat euroatlantike.

**Tabelë: Indeksi i Korupcionit të perceptuar**

Përshkrimi	1999		2000		2001	
	Radhitja	Rezultati	Radhitja	Rezultati	Radhitja	Rezultat
Estonia	27	5,7	27	5,7	29	5,6
Hungaria	31	5,2	32	5,2	33	4,9
Lituania	50	3,8	p.r.	p.r.	36	4,8
Bullgaria	63	3,3	52	3,5	45	4,0
Polonia	44	4,2	43	4,1	45	4,0
Kroacia	74	2,7	51	3,7	51	3,8
Sllovakia	53	3,7	52	3,5	52	3,7
Letonia	58	3,4	57	3,4	52	3,7
Çekia	39	4,6	42	4,3	52	3,7
Turqia	54	3,6	50	3,8	64	3,2
<b>Maqedonia</b>	<b>63</b>	<b>3,3</b>	p.r.	p.r.	p.r.	p.r.
Rumania	63	3,3	68	2,9	77	2,6
<b>Shqipëria</b>	<b>84</b>	<b>2,3</b>	p.r.	p.r.	<b>81</b>	<b>2,5</b>
Gjeorgjia	85	2,3	p.r.	p.r.	85	2,4
Moldavia	75	2,6	74	2,6	93	2,1

**Burimi: Transparency Internacional, 2002**

A) Radhitja është bërë në vitin 1999 në kuadër të 99 vendeve, në vitin 2000 në kuadër të 90 vendeve, ndërsa në vitin 2001 në kuadër të 102 vendeve.

B) Rezultati prej 10 pikëve të indeksit nënkupton "pastërtin e lartë" përderisa rezultati prej 0 pikëve të indeksit nënkupton "korupcionin maksimal".

Duke pasur parasysh se burimet e të dhënave për të vlerësuar madhësin dhe strukturën e tregjeve informale janë mjaftë të kufizuara këtë mungesë të burimeve të informacionit autorë të ndryshëm e kompenzojn nëpërmjet analizës së konsumit të mallërave në të cillat llogaritet akcizë dhe TVSH si që janë karburantet, cigaret, alkoholi, kafeja dhe mallërat e konsumit të gjërë dhe grumbullimi i tatimeve që buron nga konsumi i këytre mallërave.

- **Ndikimet e sektorit jolegal ekonomik në rritën ekonomike, në sektorin buxhetor dhe në tregun e punës**


Ndikimi i sektorit të gjërë jolegal ekonomik në rritën ekonomike në kaudër të kornizës së "ekuilibrit dual" nënkupton se ekonomia kërkon impulse shtesë për të gjet rrugën virtuale drejt aritjes së rezultateve optimale duke kombinuar angazhimet e përbashkëta qeveritare dhe të kompanive ekonomike në ndryshimin e ambientit të përgjithshëm ekonom

**Tabelë: Pjesëmarja e sektorit informal ekonomik në raport me PBB (%)**

Vendi	Popullësia	1993	1995	1999
<b>Vende në tranz. anëtare të BE</b>		<b>17,4</b>	<b>20,7</b>	<b>15,5</b>
Çekia	10,3	6,7	16,9	11,3
Estonia	1,5	19,9	24,1	11,8
Hungaria	10,2	28,0	28,5	29,0
Letonia	2,5	12,8	31,0	35,3
Lituania	3,7	11,3	21,7	21,6
Polonia	38,6	19,6	18,5	12,6
Slllovakia	5,4	7,7	16,2	5,8
<b>Vende tjera në tranzicion</b>		<b>15,8</b>	<b>35,8</b>	<b>41,8</b>
<b>Shqipëria</b>	<b>3,2</b>	<b>21,9</b>	<b>51,2</b>	<b>60,6</b>
Bullgaria	8,4	25,1	51,2	60,6
Gjeorgjia	5,4	24,9	61,0	62,6
<b>Maqedonia</b>	<b>2,1</b>	<b>18,1</b>	<b>34,0</b>	<b>35,7</b>
Rumania	22,7	13,7	16,4	19,1
Rusia	148,1	14,7	36,7	41,6
Ukraina	51,7	16,3	38,0	48,9

**Burimi: FMN, Johnon, Kaufman dhe Shleifer (1999)**


**Grafikon: Pjesëmarrja e sektorit informal në strukturën e PBB-së ( %)**



Është fakt se vendet në tranzicion të prezentuara në tabelarin e mësipërm të cilat tashmë janë anëtare të Unionit Europina kanë evidentuar trende pozitive në drejtim të eliminimit të sektorit informal të ekonomisë. Përkundrazi te vendet tjera në tranzicion të cilat janë larg përmbushjes së kriterëve të konvergencës reale integrative ekonomike dhe politike siç është rati me Maqedonin dhe Shqipërisë është evidente tendenca e keqësimit të mëtejshëm të gjendjes ekzistuese dhe rritjes së sektorit informal të ekonomisë krahasur me gjendjen në fazën fillestare të procesit të tranzicionit ekonomik.

Të dhënat edhe të viteve të fundit të publikuara nga FMN, Banka Botërore dhe insitucione të tjera ndërkombëtare konfirmojn tendecat e ngjajshme në vendet në tranzicion në varshmëri nga të ariturat në zbatimin e reformave ekonomike dhe në plotësimin e standareve dhe kriterëve të parapara me marrëveshjet për Asociim dhe Stabilizim me UE dhe me aranzhmanet me FMN dhe Bankën Botërore.

**Grafikon: Normat e rritës së PBB-së,deficiti buxhetor dhe norma e papunësis  
1993-2003 (Republika e Shqipërisë)**




**Burimi: FMN dhe Banka e Shqipërisë,**

Ekonomia e Republikës së Shqipërisë ka evidentuar trende mjaftë ambicioze të rritës ekonomike për periudhën kohore 1993-2003. Rrita mesatare e ekonomisë shqiptare inkorporon në strukturën e sajë edhe pjesëmarrjen e sektorit informal ekonomik prej mesterisht 30% fakt ky që konfirmon prezencën e sektorit informal nga vet zyratret e shtetit shqiptarë.

Rrita ekonomike është shoqëruar me deficit të lartë fiskal si rezultat të evazionit të gjërë fiskal dhe sektorit mjaftë të zhvilluar informal ekonomik. Përfundimisht me vitin 2004 të hyrat e përgjithshme buxhetore marin pjesë me vetëm 20,1% në strukturën e PBB-së që krahasuar me vendet tjera në tranzicion e radhitën Shqipërinë në vendin e fundit në kuadër të vendeve të Ballkanit Përendimor .

**Grafikoni: Normat e rritës së PBB-së,deficiti buxhetor dhe norma e papunësisë  
1993-2003 (Republika e Maqedonisë)**




Përkundër rastit të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë statistikat zyrtare nuk evidentojnë ekzistimin e sektorit informal ekonomik dhe nuk kalkulojnë në strukturën e PBB-së pjesëmarrjen e sektorit informal ekonomik. Performansat zhvillimore të ekonomisë së Maqedonisë në periudhën e deritashme tranzitore kanë qenë jashtëzakonisht të dobëta.

Niveli i përgjithshëm i PBB-së përfundimisht me vitin 2004 është në nivelin e fillimit të procesit të tranzicionit të viteve 1989-1999. Deficiti fiskal ka evidentuar trende në rritje dhe nivele të arsyeshme mirëpo si rezultat i performancave të dobëta zhvillimore të prodhimit të brendshëm pjesëmarrja e të hyrave publike në nivelin e PBB përfundimisht me vitin 2003 ka ngelur në nivelin e 33,1%. Ky nivel i sektorit publik duke pasur parasysh faktin që mbi 97% i dedikohet financimit të shpenzimeve vijuese dhe vetëm 3% financimit të shpenzimeve kapitale parqet barrë të lartë për një ekonomi me performancë të dobëta zhvillimore.

Evazioni fiskal dhe ekonomia informale gjithësesi janë pjesë përbërse e relaitetit ekonomik të Republikës së Maqedonisë pavarësisht nga mohimi i statistikave zyrtare dhe qëndrimeve të politikës zyrtare.

Të vendet e analizuar (Shqipëri dhe Maqedoni) në veçanti dallohet evazioni në lëmin e tatimeve të konsumit si dogana, akciza dhe TVSH si dhe tatimit në paga dhe kontributeve sociale.

## Grafikon: Zhvillimet në tregun e punës



**Burimi: Banka e Shqipërisë, NBRM dhe FMN,**

Përderisa te ekonomia e Shqipërisë formalisht është evidentuar ulja e normës së papunësis nga 22,3% në vitin 1993 në 15% në vitin 2003 në Maqedoni është evidentuar rritja permanente e papunësis gjatë tërë periudhës tranzitore duke aritur perfundimisht me vitin 2003 nivelin e 36,7%.

Në rastin e ekonomisë shqiptare në veçanti është mjaftë problematik numri i të punësuarëve në sektorin privat bujqësor. Autoritet shqiptare që nga fillimi i tranzicionit dhe deri në vitin 2001 manipulonin me shifrën prej 761 mijë të punësuarëve në sektorin privat bujqësor për të zbritur këtë numër në 526 mijë që nga viti 2002 pa dhënë ndonjë arsytim të argumentuar për këtë ndryshim të madhë strukturor.

Pjesëmarrja prej 59% të kategorisë së bujqëve të vetëpunësuar në numrin e përgjithshëm të të punësuarëve në ekonominë shqiptare të cilët nuk paguajn tatime në paga dhe kontribute sociale argumenton në mënyrë mjaftë transparente sektorin e gjërë informal ekonomik dhe evazionin e gjërë fiskal. Për pasojë edhe të këtij kanali të evazionit fiskal të lartë të hyart buxhetore të Shqipërisë vazhdojnë të jenë vetëm në nivelin e 20% të PBB-së përfundimisht me vitin 2003.

Nën supozimin se do të kishim korigjuar numrin e të punësuarëve sipas statistikave zyrtare në sektorin e "bujqëve të vetëpunësuar" për 30% e pjesëmarrjes së sektorit informal në strukturën e PBB-së, atëherë numri i të papunëve në Shqipëri do

të tejkalonte shifrën prej 30% dhe do të ekulibrohej me vlerësimet e ONP, vlerësime këto që janë shumë më afërt reletetit në raport me statistikat zyrtare..

Treguesit për papunësin prej 37% në rastin e Maqedonisë objektivisht nuk korespondojnë me gjendjen reale. Nga analizat e kryera në kuadër të punimeve seminarike nga studentët e Fakultetit të Administrimit të Biznesit në kuadër të UEJL në periudhën e 2004-2005 është konstatuar se në 80 kompani private të analizuar gjithëandëj Maqedonisë në pronësi etnike të përzier numri i të punësuarëve në të zezë lëvizën nga 50-80% në raport me numrin e të punësuarëve në mënyrë legale.

Evazioni fiskal në aspekt të mospagesë së tatimeve në paga dhe kontributeve sociale ose pagesës në nivele të pagës minimale arin nivelin e 60-90% të pagesave të realizuara në këtë bazë. Është më se evidente se sektori informal ekonomik absorbon një numër të konsiderueshëm të të punësuarëve në të zezë.

Angazhimi i një numri të konsiderueshëm të personave të angazhuar paralelisht në sektorin legal dhe jolegal por që nuk evidentohen si të punësuar janë karakteristikë dalluese e ekonomive të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Mos eliminimi i fenomenit të punëtoreve të angazhuar në sektorin informal nëpërmjet masave sistemore ka qenë shkakë i dështimit të më shumë nismave reformuese të perkrahura nga Banka Botërore në rastin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë.

Iniciativat e ndërmara për eliminimin e beneficioneve sociale dhe shëndëtsore për të papunësuarit nuk kanë përmirësuar fleksibilitetin e tregut të punës në harmoni me programet e projektuara reformuese.

- **Vlerësime përfundimtare**

- Sektori jolegal ekonomik të vendet në tranzicion ka një pjesëmarrje të konsiderueshme në kuadër të aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, kjo pjesëmarrje sipas vlerësimeve të autorëve të ndryshëm lëvizën nga 30-60% të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Një pjesëmarrje kaq e lartë e sektorit informal ekonomik efektua evazion të lartë fiskal dhe një distorzion të lartë të tregjeve në përgjithësi si dhe të tregut të punës në veçanti.

- Për pasojë të një sektori të gjërë jolegal ekonomik, të ardhurat buxhetore krahasuar me performancat ekonomike të përgjithshme janë mjaftë të dobëta, sektori privat ekonomik kryesisht është i destimuluar nga raportet e dobëta të tatimpaguesve dhe shërbimeve të dobëta publike dhe ekzistimit të pjesëmarrësve të shumtë me përparësi konkurruese që buron nga tregu informal.

- Në rastet e vendeve në tranzicion të EJL dhe në ato suaza në Maqedoni dhe Shqipëri nuk bëhet fjalë për norma të larta të tatimeve dhe të kontributeve sociale, por për zbatimin joefektiv të ligjeve tatimore që efktoon evazion të gjërë fiskal dhe zhvillim të një sektori të fuqishëm të ekonomis informale.

- Sfida principiele e qeverive të vendeve në tranzicion ka të bëjë me implementimin përfundimtar të reformave në administratën publike dhe zbatimin e strategjive anti-korupcion me objektiv përmirësimin e menaxhmentit publik në administratën doganore dhe tatimore, në shërbimin policor, në prokurori dhe gjykata.

- Qeverit e vendeve në tranzicion duhet detyrimisht të bëjnë reformimin dhe ristrukturimin e administratës publike-fiskale duke stimuluar financiarisht të punësuarit në administratën fiskale në varshmëri nga rritja e të ardhurave fiskale dhe luftimi i evazionit fiskal.

- Lufta kundër evazionit fiskal dhe ekonomis informale nuk duhet të jetë prioritet strategjik vetëm i ministris së financave dhe administratës tatimore por në evitimin e evazionit fiskalë dhe ekonomis informale duhet të kenë angazhim të koordinuar edhe të pushteteve komunale, kompanive ekonomike private dhe qytetarëve të angazhuara në sektorin formal ekonomik me qëllim të eliminimit të disavantazheve të kostos që burojnë nga funksionimi i sektori jolegal i ekonomis.

- Konstatimi i ekonomistit të madhë gjerman **Joseph Shumpeter** se: "Shpirti i një populli, niveli i tij kulturor, struktura e tij shoqërore, veprat të cilat politika e tij mund ti pregadit, të gjitha ato edhe shumë më tepër janë të regjistruara në historin e tij tatimore. Ai që di ti dëgjoj këto porosi do të dij të dëgjoj klithmat e historis botërore më qart se nga çdo burim tjetër, "nuk ka humbur nga aktualiteti edhe sot kur janë pyetje ekonomit e vendeve në tranzicion.

**Literatura e konsultuar:**

- 1.Rufi Osmani, "Bashkëpunimi i Shqipërisë dhe Maqedonisë me FMN dhe Bankën Botërore" punim I Doktoraturës, 2004 , Prishtinë,
- 2.Richard Allen and Daniel Tommas, "Managing Public Expenditure", A Reference Book for Transition Countries, 2004 OECD,
- 3.The World Bank, The IBRD, "Transition, The First Ten Years, Analysis ma lessons for Eastern Europe and The Former Soviet Union", 2002, Washington,
- 4.L.Bokros and J.K.Dethier, "Public Finance reform during the transition: The Experience of Hungary" 1998,
- 5.Banka e Shqipërisë,Raporte vjetore 1993-2003,Tiranë,
- 6.NBRM, "Godishni Izveshtaji,1993-2003",Shkup
- 7.Vito Tanzi, "Transition and the changing role of the government" material i FMN,
- 8.Web faqeja e FMN, materiale të ndryshme,
- 9.Web faqeja e Bankës Botërore, materiale të ndryshme,